

## Shpallja dhe kriteret minimale kualifikuese për furnitorët e interesuar

Shkolla/Komuna: **SHFMU."Halil Alidema", Pozheran-Viti**

Data e shpalljes: 09.02.2012

Emri i pakos: Blerja e mjeteve mësimore

Numri i marrëveshjes së grantit shkollor: IDEP/SDG/156

Numri i referencës: C1.3/SDG/156/BL2

Qeveria e Kosovës ka pranuar një grant nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZh) të Bankës Botërore për Projektin për Zhvillimin Institucional në Arsim (IDEP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **\_SHFMU."Halil Alidema" -Viti\_**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

Blerja e lektyrave shkollore prej I-IX , atlasave, fjalor shkollor si dhe mjete mësimore nga lëndët: Kulturë muzikore ( sintisajzer, çifteli, fyell, violina, daire, mandolina) dhe nga edukata fizike ( tabela për basket, konstruksioni i basketbollit,shporta, rrjeta të volejbollit,topa dhe dyshek për gjimnastikë).

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim të cekura më lartë janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën **\_SHFMU "Halil Alidema" Pozheran -Viti\_** më së largu deri më **\_22.02.2012\_**

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertim-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencial që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Mufail Halabaku** nr tel. 044-280-881

mufail\_halabaku@hotmail.com